

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Gjuhë angleze

(klasa e tetë)

Tiranë, 2005

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. TË PËRGJITHSHME
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE
- III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
- IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT
 - 1) Sfera tematike dhe leksiku
 - 2) Aktet / funksionet komunikative
 - 3) Elemente dhe struktura gramatikore
 - 4) Shpërndarja e orëve
- V. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- VI. VLERËSIMI DHE VETËVLËRËSIMI
- VII. KRITETET E HARTIMIT TË TEKSTEVE

I. TË PËRGJITHSHME

Gjuha angleze në klasën e 8-të do të zhvillohet në përputhje me planin mësimor të miratuar nga MASH që parashikon një ngarkesë javore prej tri orësh në javë dhe një ngarkesë vjetore prej 105 orësh mësimore.

Mësimi i gjuhës angleze në këtë klasë synon të përcjellë, të përforcojë, të zgjerojë dhe të thellojë njohuritë e fituara deri në këtë shkallë të arsimit të detyruar 9-vjeçar, duke ndihmuar në formimin e përgjithshëm të nxënësve nga ana gjuhësore, kulturore dhe intelektuale.

Njëherazi i mundëson nxënësit të shprehet më mirë duke zhvilluar më tej të katra aftësitë për t'u përballur kësaj më shkëmbimet në gjuhët e huaja.

Nga pikëpamja strukturore programi paraqet në mënyrë të sintetizuar njohuritë gjuhësore, aftësitë dhe shprehjet komunikuese si dhe vlerat kulturore që do të jenë, edhe objektivat kryesorë të zhvillimit të mësimin përgjatë vitit shkollor.

Niveli gjuhësor rritet në mënyrë spirale duke përsëritur çka është zhvilluar në klasat e mëparshme dhe duke nxënë njohuri të reja në mënyrë të përshkallëzuar.

Synimet dhe objektivat e parshtruar në këtë program bazohen mbi ato të programuara për klasat pararendëse, duke u rishtrirë në shërbim të nivelit ku hyjnë nxënësit.

Programi i këtij niveli mban parasysh si grup-moshën e nxënësve dhe karakteristikat e tyre përkatëse. Në të përfshihen tema, objektiva, akte dhe funksione komunikuese që jo vetëm lidhen me interesat e tyre moshore, por edhe nxitin interesin dhe zgjojnë kureshtjen e tyre.

II. SYNIME EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE

Mësimi i gjuhëve të huaja, në përgjithësi, dhe i gjuhës angleze, në veçanti ndihmon në rritjen e mundësive që u afron shkolla nxënësve për zhvillimin e aftësive gjuhësore, ndërgjegjësimin e tyre ndaj kulturave të tjera, si dhe në nxitjen e përgjegjësisë të nxënësve dhe mësuesve për të respektuar të tjerët dhe për t'u respektuar prej tyre, për të qenë tolerantë ndaj mendimeve të të tjerëve dhe për t'u përgjigjur kërkesave për të qenë qytetarë evropianë me të gjitha të drejtat.

Kjo për faktin se gjuha është :

- mjet i të menduarit (pra mjet për kryerjen e një sërë operacionesh mendore);
- mjet për të vendosur marrëdhënie shoqërore;
- mjet i shprehjes së mendimeve, të ndjenjave dhe gjendjes shpirtërore;
- mjet për shprehjen e kulturës.

a) Synimet edukative

Mësimi i gjuhës angleze në klasën e 8-të në aspektin edukativ synon:

*Të familjarizojë nxënësit me aspektet dhe praktikat kulturore të vendeve anglishtfolëse; të mundësojë zgjerimin e hapësirave formuese, kulturore dhe njohëse të personalitetit të nxënësit, duke ndihmuar kështu në formimin e personalitetit të tij, si dhe në përfshirjen e tij në ndërveprim sociokulturor.

*T'i ndihmojë nxënësit në krijimin e shprehive për një punë fillestare të pavaruar, si dhe për të përdorur strategji të të mësuarit që i bëjnë ata sa më krijues.

*Të fillojë t'i aftësojë nxënësit të ndërveprojnë aktivisht në situata jetësore jashtëshkollore, duke përdorur modelet që ofrohen në situata të caktuara mësimore.

b) Synime didaktike

Të mësuarit e gjuhës angleze në këtë nivel shkollor synon :

Të zhvillojë aftësitë gjuhësore të nxënësve që ndihmojnë formimin e përgjithshëm të tyre, si dhe t'i aftësojë ata të përdorin gjuhën për qëllime praktike. Konteksti gjuhësor ofron modele të të sjellurit në situata të caktuara mësimore. Kjo realizohet:

1. Vendosja e nxënësit në qendër të vëmendjes. Programi merr parasysh nxënësin, njohuritë e tij, aftësitë e grup-moshës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake.

Kështu shtjellimi i njohurive të reja lidhet drejt për drejt me ta.

2. Krijimi i mjedisit të të nxënësve. Të mësuarit efektiv realizohet në një mjedis shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, në një mjedis në të cilin nxënësi ndjehet i sigurt. Kjo arrihet kur menaxhimi dhe organizimi i veprimtarive të të nxënësve siguron vëmendjen, interesin dhe përfshirjen e nxënësve në mësim.

3. Organizimi i klasës. Mësuesi përdor mënyra të ndryshme të organizimit të klasës që krijojnë e ruajnë një mjedis mbështetës dhe rrisin motivimin e nxënësve. Organizimi i mësimit mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atyre u krijohen mundësi apo lehtësi për të eksploruar në gjuhë, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tyre. Atmosfera e klasës është mbështetëse dhe respekt për përgjigjen e nxënësit si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënësi ndërkohë mëson edhe nga shokët e tij. Herë pas here nxënësi punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

4. Të mësuarit bashkëveprues/kooperues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin, ndihmojnë të folurit e rrjedhshëm dhe zhvillojnë shkathhtësi sociale. Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ndihmon gjithashtu në shoqërimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesit, nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

5. Përdorimi i gjuhës në klasë. Gjuha angleze është mbizotëruese gjatë orës së mësimit. Mësuesi që është nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës angleze në klasë, minimizon në maksimum përdorimin e gjuhës amtare.

6. Të mësuarit e gramatikës. Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten në gramatikën komunikuese. Nxënësit mësojnë gramatikën në shërbim të komunikimit. Në

këtë nivel jepet një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për qëllime komunikimi. Gramatika jepet dhe mësohet në mënyrë induktive nëpërmjet materialeve autentike. Nxënësit, gjatë të gjithë procesit të nxënies, ekspozohen ndaj dukurive të reja gramatikore.

7. Qortimi i gabimeve. Gabimet duhet të qortohen, por kjo në kohën dhe vendin e duhur. Vërejtjet, këshillat dhe qortimet e mësuesit, të shokëve ose dhe të vetë nxënësit ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe vërtetërespektin. Qortimi pa kriter mund të çojë në frenimin e nisëativës, heqjen e dëshirës për të folur, demotivimin, madje mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimi. Mësuesi ndërhyt me takt, dhe, duke përdorur forma të larmishme qorton më shpesh kur nxënësit praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë kur nxënësit janë duke punuar në grup, kur janë duke debatuar apo duke diskutuar për tema të ndryshme.

8. Vazhdimësia dhe rimarrja. Edhe në klasën e 8-të programi i gjuhës angleze njih rolin e vazhdimsisë dhe të riciklimit si bazë e të mësuarit të gjuhës së huaj. Progresi kalon nga e thjeshta në të vështirën, nga konkretja në abstrakte. Studimet dhe eksperimentimet kanë provuar se zakonisht për të përvetësuar elementet e reja gjuhësor, një nxënës ka nevoje të ekspozohet ndaj tyre shtatë herë, në shtatë kontekste të ndryshme; pra rimarrja është e domosdoshme.

III. PËRSHKRIMI AFTËSIVE GJUHËSORE

Shënim.

Vlen të ritheksohet se zhvillimi i aftësive gjuhësore realizohet i integruar gjatë të gjithë procesit mësimor. Përshkrimi i niveleve nuk mund të merret i izoluar. Ai shqyrtohet në suazën e përshkrimit të niveleve të arritura deri në fund të klasës së shtatë. Mësuesi mbështetet në përshkrimin e niveleve për të ndërtuar strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies dhe të vlerësimit . Njëherazi ai i përdor ato për të përcaktuar shkallën e përparimit, të përvetësimit dhe arritjeve të nxënësve.

Në fund të klasës së tetë nxënësit:

- Shprehin qëndrimet e tyre, japin këshilla, urdhra drejtpërdrejt apo tërthorazi, bëjnë ndërhyrje, paraqitjee, marrin dhe japin leje e të tjera.
- Shprehin pëlqimin, mospëlqimin për diçka.
- Përshkruajnë ngjarje të jetës së përditshme, njerëzit që i rrethojnë, vendet, hobitë e tyre etj., duke përdorur shprehje të ngulitura, fjali komplekse, gjuhë të thjeshtë formale dhe informale.
- Marrin dhe japin informacion për temat të njohura.
- Shprehin nevojat e tyre vetjake.
- Në aspektin gjuhësor bëjnë dallimin ndërmjet pjesëve kryesore të ligjëratës, si dhe fjalorit bazë.

Përshkrimi i nivelit për dëgjimin

Nxënësi në përfundim të klasës së tetë është i aftë:

- Të ndjekë biseda të përditshme të artikuluar qartë që i drejtohen atij, dhe shpesh kërkon përseritjen të fjalëve dhe shprehjeve të vecanta.

- Të ndjekë përgjithësisht, thelbin e një bisede të zgjatur rreth tij, kur gjuha e përdorur është e qartë dhe standarte.
- Të dëgjojë një tekst të shkurtër dhe ngrerë hipoteza rreth asaj që do të ndodhë më pas, të kuptojë materiale të thjeshta të rregjistruara për probleme të interesit të vet, të shprehura relativisht ngadalë dhe qartë.
- Të kapë thelbin e programeve televizive mbi tema të njohura ku ngjarjet e treguara shoqerohen me veprime dhe figura.
- Të kuptojë të dhëna të thjeshta teknike nga instruksionet për kompjuterin, makina llogaritëse, TV e paisje të tjera.

Arritja e aftësisë në dëgjim do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë:

- *dialogjesh* që lidhen me:
 - situata në familje, në mjedisin shkollor, në mjedise publike (dyqan, bar etj.), kremtime, hartime ftesash;
 - situata me lojërat dhe kohën e lirë;
 - informacione për shkollën, familjen, argëtimin etj.
- *monologjesh* që lidhen me:
 - lajmërimet shkollorë, njoftime të shkurtëra radiotelevizive, përshëndetje me mysafirët, biseda të ndryshme etj.

Përshkrimi i nivelit për të folurit

Nxënësi në përfundim të klasës së tetë është i aftë:

- Të fillojë të vazhdojë dhe të përfundojë një bisedë për një temë shumë të njohur dhe me interes për të.
- Të marrë pjesë në një bisedë apo diskutim, por mund të ndodhë që të mos kuptohet plotësisht nga bashkëfolësi.
- Të shprehë ndjenja të tilla, si: habi, gëzim, trishtim, kurjeshtje dhe të reagojë ndaj të njëjtave ndjenja të shprehura nga të tjerët.
- Të shkëmbejë mendime në një diskutim të thjeshtë ndërmjet të njohurish.
- Të tregojë një histori, një përvojë me gjuhë të thjeshtë.
- Të sqarojë shkurt qellimet, planet dhe veprimet e tij.
- Të tregojë përmbajtjen e një libri apo të një filmi thjeshtë duke përshkruar reagimet e tij.
- Të përsërisë pjesërisht atë që thotë folësi për t'u siguruar që kuptohen ndërmjet tyre.
- Të përdorë fjalë më të thjeshta në vend të fjalëve që nuk i kupton.
- Të flasë në mënyrë të kuptueshme, por duke bërë pauza, për të menduar atë që do të thotë.
- Të zotërojë një leksik të mjaftueshëm për t'u shprehur për shumicën e temave që lidhen me jetën e përditshme.

Arritja e aftësisë së të folurit do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë:

- *monologjesh* në të cilat:
 - di të flasë për veten, familjen, miqtë, vende, persona, botën e imagjinatës dhe të krijimtarisë etj.;

- flet për mësimet, për kohën e lirë, pasionet, zakonet vetjake, kulturën popullore, përshkruan një përvojë të caktuar;

- *bashkëveprimi* me mësuesin/nxënësit për tema të njohura;
role-play të thjeshta, në të cilët riprodhohen situata të njohura

Përshkrimi i nivelit për të lexuarit

Nxënësi në fund të klasës së tetë:

- Lexon artikuj ose intervita në gazeta ose revista për tema dhe ngjarje aktuale dhe kupton në mënyrë të përgjithshme thelbin e informacionit.
- Nxjerr nga konteksti i tematikave të njohura kuptimin e fjalëve të veçanta të panjohura, si dhe të frazave apo shprehjeve më komplekse.
- Gjen dhe kupton informacionin apo faktet e kërkuara (p.sh., kush, ku dhe kur është kryer diçka) duke i hedhur një vështrim të shpejtë teksteve të shkurtëra, si, p.sh., përmbledhjes së lajmeve.
- Kupton informacionin më të rëndësishëm nga broshurat e shkurtëra, të thjeshta me informacione të jetës së përditshme.
- Kupton mesazhe të thjeshta dhe letra standarde rreth udhëtimeve, shërbimeve postare, blerjeve etj.
- Kupton korrespondencën e tij lidhur me ngjarje, ndjenja apo dëshira të grup-moshës së vet.
- Kupton subjektin e një tregimi të strukturuar mirë dhe dallon ngjarjet dhe episodet më të rëndësishme, si dhe elementet më thelbësore në to.
- Kupton tekste të shprehura me gjuhë të përdorimit të përditshëm.
- Kupton në nivel të kënaqshëm tekste faktike të mirfillta (pa nëntekste) për tema e subjekte që lidhen me interesat e tij.
- Kupton instruksione, manuale të thjeshta për përdorimin e pajisjeve elektroshtëpiake, të telefonit, kompiuterit etj.

Arritja e aftësisë në të lexuar do të realizohet nëpërmjet materialeve gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste, si:

- kartolina, letra;
- fletëpalosje, tabela apo reklama, gazeta e revista;
- lajmërimi, udhëzime të thjeshta (rregulla ushtrimi, loje etj.);
- paralajmërimi rreziku etj.

Përshkrimi i nivelit për të shkruarit

- Shkruan tekste të thjeshta për tema të ndryshme, duke lidhur në seri elementet e rëndësishme.
- Përshkruan një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar, me fjali të thjeshta për një gazetë shkolle ose rrethin jashtëshkollor ku mund të bëjë pjesë.
- U shkruan letra shokëve apo të njohurve, për t'i pyetur, për t'u dhënë informacion apo për t'u treguar për ngjarje a ndodhi.
- Shkruan përmbajtjen e një libri për fëmijë, të një filmi a të një koncerti.
- Shkruan një letër, duke shprehur në të ndjenjat e tij, si: gëzim, trishtim, simpati, keqardhje etj.

- Harton një faks, një e-mail, një mesazh për t'ua transmetuar në formë informacioni të thjeshtë e të shkurtër të njohurve, si dhe kërkon informacion po në këtë mënyrë.
- Harton një biografi mësimore të thjeshtë në formën e një tabele.
- Harton letra, kartolina, SMS dhe tekste të shkurtëra, mjaft të kuptueshme, me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë për veprimtaritë e përditshme.

Arritja e aftësisë në të shkruar do të realizohet nëpërmjet materialesh të shkruara, si:

- module apo formularë (shkolle, biblioteke etj.);
- kartolina, letra;
- lajmërimë në një kënd lajmërimesh apo në gazeta për fëmijë, receta kuzhine, përgatitje posterash, përdorim materialesh burimeve etj.

Aspekte fonetike

Edhe në klasën e tetë vazhdon riciklimi i të gjitha shprehive fonetike e fonologjike të përvetësuara deri në këtë shkallë të mësimi të gjuhës angleze duke zbatuar teknika të fonetikes korektive.

Përpos tyre në klasën e tetë i kushtohet vëmendje e vecantë dukurive të mëposhtme të intonacionit;

- Intonacionit të fjalive kur duam të jemi të mirësjellshëm dhe miqësor.
For Example
It was a very nice party?
\ Yes.
I met Bob in the street on Monday.
\ Well.
- Intonacioni të fjalive kur kërkohet të përsëritet një pjesë e informacionit të cilin nuk e kemi dëgjuar mirë.
For Example
I am leaving at ten.
/ When?
- Intonacionit të situatave kur kërkohet të shpjegohet diçka mbasi dëgjuesi habitet për të ndonëse, mund ta ketë dëgjuar mirë.
For Example
John has got same business friends there.
/ Business
You know John never stops working.
- Fjali thirrrore emfatike.
For Example
What a \ beautiful day?
\ Isn't she nice?
- Shqiptim të grupeve ritmike.
For Example
John has (əz) just been (bintə) to London.
I can (kən) come in the afternoon.
Come and (ən) play.
I am going to (tə) London.

IV. PERMBAJTJA E PROGRAMIT

1. Topics

Every day life

Free time: Teenage activities
Planning your time & making a schedule
Sports
Devide the household chores
Food and energy
Personal Information
Life style
Personal plans
School days
Personal feelings

School life and work

Planning class trips
School rules and regulations
Learning and school
Design an ideal school

Personal and social life

Teenagers' concerns
Holidays
Club membership
Personality
Relationships (friendship)
Local changes (Improve your hometown)
Plan your party menu

World around us

Traveling and tourism
Culture shock
Save the planet
Wildlife preservation
Land marks and monuments
Neighbors and neighborhoods, environmental concerns, social responsibilities

World of communication

Science and technology (inventions and discoveries)
Telephone
Radio
Music
Current events (local, national or international)

2.Communicative acts / functions

Introducing and socializing

For Example

Have you met Mr.....

You don't know..... do you

Fine weather, isn't it?

Nice day..... isn't it

Expressing encouragement

For Example

Nice of you

Kind of you

Well done

Good for you

Hard luck

Expressing preferences

For Example

I like watching old films

She loves doing puzzles

He enjoys reading horror stories

We hate getting up early

I don't like talking about myself

I'd prefer to go to the cinema tonight

I'd love to try hang-gliding

Making requests and offers

For Example

Could you wrap this present, please

Can you tell me the code to London?

Could I have the bill please

Would you mind opening the window ?

Shall I help you with the dishes?

I will look it up

Giving advice

For Example

You should eat proper meals instead of fast-food

You should go to bed early in stead of watching TV until midnight

Why don't you go jogging ?

You had better exercise in a gym

I don't think you should wear a coat

I think you shouldn't smoke

Parents ought to help their children with their homework

The government ought not to allow smoking in public places

Expressing agreement and disagreement

For Example

I agree

That's true

You're right

I can't agree with you
I disagree about it
I am afraid you're wrong

Asking for information

For Example
Could you send me?
Could you tell me about the facilities?
How long are the courses?
How much do they cost?
I'd like a form please
What about the accommodation ?
What kind of activities are there?

Stating rules

For Example
No smoking
Take your rubbish away with you
Please, don't pick the flowers
You aren't allowed to camp here

Discussing plans

For Example
I am going to travel abroad
How long are you going to stay?
Are you staying long?
I am going to
If I go to Germany, I'll walk in the black forest

Making comparisons

For Example
Life has become more expensive
People worry much more about money
For me reading is more useful than playing computer games

Giving reasons

For Example
I'm applying for a visa so that I could travel abroad

Expressing purpose

For Example
He wrote (in order) to tell us about his news

Asking for repetition / clarification

For Example
Sorry., what did you say
Pardon
Sorry, can you repeat it please

Making suggestions

For Example

I think we should try again

How about going shopping

Why don't we go home

You had better tell them the truth

Let's go to the cinema

Shall we watch the new film

3. Language structures

Present simple and present continuous (review)

State and activity verbs

For Example I think it's a great idea

I am thinking about my exam

Present perfect (for + since)

We've been best friends since we were kids

We've been best friends for years

Present perfect (has gone, has been)

For Example

A. Can I talk to Peter please

B. I'm afraid you can't. He's gone to USA

A. You look brown

B. I've been on holiday

Past simple and past continuous

For Example

The spectators were taking their seats when we arrived

Present perfect continuous

For Example

I've been using the bike for the last two months

The boy has a black eye. He has been fighting with a friend

The passive (present and past)

For Example

Cars are regularly stolen in this area

The ceremony was reported in the news last night

Future forms (present continuous, going to, will)

For Example

OK, I'll help you

I think she will pass the exam

I'm going to study law

It's going to rain

I'm going out with my friends tonight

Past perfect

For Example

The film had begun when they arrived at the cinema

Reported speech (requests, orders, statements)

For Example

The teacher asked the students to close their books
The doctor told them not to worry
He said that he wanted to help us

Conditionals (zero and first)

For Example

If you want to study in America you have to pass an exam in English
If we save enough money, we can go on holiday
You don't get fit unless you exercise regularly

Verb patterns

verb + ing form (adore, hate, enjoy, don't, mind, prefer, suggest)

For Example

I prefer walking to school
I hate getting stuck in traffic jams

verb + infinitive (agree, choose, decide, learn, promise, refuse, want, would like
/ love / prefer

e.g. We agreed to discuss the plan in the afternoon

verb + infinitive without to (make, let (smb) do smth)

e.g. The parents make us go to bed early

Modal verbs (should (not), ought to) for obligation

For Example

There should be policemen in all National Parks
People shouldn't break the rules or they will be punished
Teenagers ought to take responsibility of their actions

Relative pronouns (who, that, which, where)

For Example

The girl who has got blue eyes is my classmate
The book that I bought yesterday is very good
This is a photo of the hotel where we stayed

Indefinite pronouns (someone, something, anyone, anything, somewhere, anywhere, everything, nothing)

For Example

I can't find my keys. I've looked every where.
Stop talking. Nobody wants to listen to you.

Reflexive pronouns (myself, yourself, herself, himself, itself, ourselves, yourselves, themselves)

For Example

They enjoyed themselves at the party.
He wrote the composition himself

Position of adverbs

For Example

I am very interested in other cultures

I think carefully before I choose a book

She usually watches TV every evening

Linking words

of reason (because, because of)

E.g We didn't go on picnic because of the rain

of contrast (although, despite, however)

E.g Although it was raining, they won the match of giving examples (for example, especially, such as)

e.g She likes extreme sports especially bungee- jumping

It's strange she loves two different things such as poetry and maths

Common phrasal verbs with take, turn, put, look, get, give, go (take off, put on, turn off, turn on, get over, give up, etc.)

4. Shpërndarja e orëve

35 javë x 3 orë = 105 orë vjetore

Aspekti komunikues-kulturor:	57 orë
Aspekti gjuhësor:	38 orë
Të lira:	10 orë
<i>Gjithsej:</i>	105 orë

Aspekti komunikues- kulturor (57 orë). Pa rënë ndesh me parimin e autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, përgjithësisht këshillohet që afër 32 orë mësimore t'u kushtohen veprimtarive me karakter komunikimi, përfshirë këtu të ushtruarit, në situata komunikimi të njohurive, strukturave, nocioneve që ngërthejnë materialet e ndryshme didaktike, si: teksti, materiale integruese etj., rimarrjen dhe përsëritjen e njohurive të fituara deri në atë pikë, rimarrjen dhe përforcimin deri në ngulitje të funksioneve, nocioneve e strukturave komunikuese më të rëndësishme.

Aspekti gjuhësor (38 orë). Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi ftohet të shtjellojë, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore, ushtrime gjuhësore (gramatikore e leksikore), rimarrje dhe përforcim të atyre të mësuara më parë apo edhe të atyre të reja.

Të lira (10 orë). Në këto orë të lëna në dispozicion të mësuesit, mund të zhvillohen orë përsëritjeje, detyra kontrolli, plotësim të orëve kushtuar aspektit qoftë komunikativ, qoftë gjuhësor.

Shembuj për përdorimin praktik të programit për aftësitë gjuhësore

Të dëgjuarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Leksiku, struktura
Ndjek thelbin e një bisede të zgjatur rreth tij, kur gjuha folur është artikuluar qartë dhe kur është përdorur një gjuhë standarde.	Jeta e përditëshme: Veprimtari të kohës së lirë e planifikimi i tyre.	Shprehin dhe kuptojnë pikëpamje për interesat.	Jeta e një adoleshenti: Përcaktojnë pikëpamjet për veprimtaritë në kohën e lirë dhe bëjnë planifikimin e tyre.	Diskutojnë përparësitë e paraqesin mundësitë, miratojnë dhe programojnë kohën e lirë.

Të folurit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Leksiku, struktura
Fillon, vazhdon dhe përfundon me bashkëfolësit një bisedë për një temë të njohur ose që paraqet interes.	Bota rreth nesh: monumentet dhe muzetë.	Diskutojnë e argumentojnë rëndësinë e vlerat e muzeve për informim kulturor e turizëm	Muzeu folklorik: argumentojnë rëndësinë e kulturës dhe të ruajtjes së saj.	Shprehin qëndrimet dhe i mbështesin me argumente ato.

Të lexuarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Leksiku, struktura
Kupton informacionin më të rëndësishëm nga broshura të shkurtëra e të thjeshta me të dhëna nga jeta e përditshme.	Bota rreth nesh: ruajtja dhe respektimi i natyrës.	Kuptojnë, reagojnë ndaj shkrimeve me përmbajtje disi të panjohur.	Natyra e parqet kombëtare: kuptojnë e miratojnë respektimin e rregullave publike.	Kuptimi dhe reagimi ndaj përgjegjësisë dhe detyrimeve shoqërore.

Të shkruarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Leksiku, struktura
Përshkruan një udhëtim real me fjali të thjeshta për një gazetë shkolle apo rrethin jashtëshkollor ku mund të bëjë pjesë.	Jeta vetjake dhe shoqërore: pushimet.	Japin informacione përshkruajnë vende, ndjenja e qëndrime.	Pushimet verore: përshkruajnë përjetime, mbresa e ndodhi.	Shkruajnë në paragrafe sekuenca ngjarjesh dhe shprehin qëndrimet e tyre.

Programi për klasën e tetë parashikon një fjalor aktiv prej rreth 850-900 njësisish leksikore. Riqarkullimi, rifreskimi dhe pasurimi do të jenë hallka të një procesi të vazhdueshëm, të lidhura ngushtë me temat që do të trajtohen, si: pushimet, sporti, muzika pasi fjalët do të mësohen në kontekstin e tyre tematik, prandaj bashkimet e fjalëve, shprehjet frazeologjike, togfjalëshat, do të zënë një vend të ndjeshëm në këtë nivel. Fjalori, gjithashtu, trajtohet i lidhur ngushtë edhe me aspektet gramatikore. Prandaj nxënësit do të mësojnë edhe identitetin gramatikor të fjalëve përmes fjalëformimit.

V. VLERËSIMI DHE VETEVLERESIMI

Programi, nëpërmjet përdorimit të niveleve të zhvillimit të katër aftësive, të tematikave, të strukturave gjuhësore dhe akteve të komunikimit, përcakton standarde të pritshme për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga ndryshimet e tyre individuale e motive kulturore dhe gjuhësore.

Vlerësimi është konstruktiv, bëhet në mënyrë sistematike dhe ndërthuret gjatë të gjithë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në kohë të përshtatshme.

Kontrolli dhe vlerësimi i nxënësve nxit përparimin e mëtejshëm të tyre dhe krijon harmonizimin në kalimin e një veprimtarie në tjetrën. Mësuesi kujdeset për krijimin e një

klime të qetë ku nxënësi nxitet dhe nuk tensinohet nga frika e vlerësimit. Vëretjet dhe këshillat e mësuesit ndihmojnë për të rritur vetëbesimin dhe vetërespektin.

Mësuesit realizojnë ballafaqimin e nivelit të përparimit individual e kolektiv duke mbledhur vazhdimisht informacion për zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe të aftësive. Ata vlerësojnë përparimin sistematik të nxënësve nëpërmjet vëzhgimeve, pyetjeve, testeve dhe detyrave me shkrim në shtëpi e klasë dhe sigurohen nëse nxënësit vazhdojnë të bëjnë përparime të dukshme në përvetësimin e dijeve, të shprehive të të kuptuarit dhe të të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Mësuesit monitorojnë dhe qortojnë detyrat duke përcaktuar objektiva të qartë.

Format e ndryshme të vlerësimit njëherazi i ndihmojnë nxënësit të përfitojnë dhe të konsolidojnë njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit e të shprehurit për njohuritë e përfshira në këtë program. Detyra të studiuar specifike me objektiva të qartë që përforcojnë dhe çojnë më tej njohuritë e fituara, mundësojnë nxënësit të konsolidojnë njohuritë e tyre si në klasë, ashtu edhe në shtëpi.

Mësuesi u kushton vëmendje gabimeve dhe ndihmon në qortimin e tyre.

Kontrolli gojor, megjithë karakterin e vetë subjektiv, mbetet një element i rëndësishëm i vlerësimit të arritjeve. Kontrolli periodik me shkrim jep një informacion më të plotë për rezultatet e arritura.

Testet diagnostikuese të arritjeve, të progresit, të përcaktimit të niveleve, si edhe kuizet të jenë realiste, me objektiva të qartë e të matshëm.

Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv dhe motivues, mund të përdoren tipat e mëposhtëm të ushtrimeve:

-Përsëritje, dialogje të drejtuara dhe të hapura, intervista, simulime, plotësime,

-Pyetje të tipit e saktë apo e gabuar, pyetje të hapura, pyetje alternative; plotësime hartash, rrjeta semantike;

-Dikttime, riformulime fjalish, plotësim fjalish, zëvendësime fjalësh, ndërtim fjalish, qortime gabimesh, hartime të drejtura e të tjerë.

Mësuesi njëherazi i përdor këto vlerësime për të përmirësuar aspekte të ndryshme të punës së tij, shikon në mënyrë kritike metodat e tij të mësimdhënies dhe mban qëndrim po në mënyrë kritike për të përmirësuar efektivitetin e tyre.

Edhe vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze. Nxënësit vlerësojnë nga ana e tyre zotërimin e objektivave dhe standardeve të përshkruara në programl.

Vlerësimit nxit të mësuarin e pavarur gjatë gjithë jetës dhe ndërgjegjëson nxënësit të kuptojnë më mirë problemet e të mësuarit.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Nisur nga fakti që vetëvlerësimi nuk ka qenë pjesë e traditës sonë arsimore, ai njëherazi mund të merret edhe si aspekt problematik që shtron pyetje të tilla: “Si është e mundur që nxënësit të vlerësojnë vetveten?”, “A kanë ata njohuri të mjaftueshme?”, “A mund të jenë objektivë?”, “A mund të jetë vetëvlerësimi i besueshëm?” etj .

Në procesin e mësimit të gjuhëve të huaja vetëvlerësimi mund të përqëndrohet në tri aspekte kryesore:

1. Në procesin e mësimit, që do të thotë vlerësimin e progresit të tyre, nivelin e arritur në secilën shkallë dhe suksesin ose mosesuksesin në realizimin e detyrave dhe objektivave të caktuar.
2. Në aftësitë e tyre komunikuese.

3. Në zotërimin e gjuhës, pra në leksikun që zotëron, në strukturat gjuhësore dhe mënyrën se e artikulon gjuhën.

VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TW PROGRAMIT

Programi i klasës së tetë synon të orientojë gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës angleze në këtë nivel.

Ai ofron një gjerësi sferash tematike, me tema e tyre përkatëse, rreth së cilave do të pozicionohen funksionet dhe strukturat gramatikore. Programi sintetik këshillon një mënyrë të përgjithëshme të ndarjes së orëve. Do të jetë mësuesi që bazuar në orintimet didaktike, do të planifikojë, në varësi të nevojave dhe nivlit gjuhësorë të nxënësve, detajet e shtrirjes së orëve gjatë vitit shkollor.

KRITERET PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË GJUHËS ANGLEZE PËR KLASËN E TETË

Teksti “Gjuha angleze-8“ të pasqyrojë këtë program të lëndës.

Këshillohet që teksti të përbëhet nga 2 pjesë, nga libri i nxënësit dhe fletorja e punës, si dhe mundësisht kasete për të zhvilluar aspektin e të dëgjuarit.

Në hartimin e tekstit “Gjuha angleze-8” të realizohen dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mëposhtme:

1. Programi i hartuar për këtë klasë.
2. Zgjedhja dhe seleksionimi i materialit të bëhet për një publik dhe mjedis në përputhje me moshën.
3. Autorët janë të lirë të shpërdajnë temat, funksionet, strukturat gjuhësore në përshtatje me qëllimet mësimore, kulturore dhe ndërthurjen e tyre si dhe të nxisin punën krijuese të mësuesit.
4. Teksti të jetë i ndarë me njësi didaktike dhe me linja të caktuara që realizojnë objektivat e parashtrur në program. Materiali të jetë tërheqës dhe me ngjyra.

Këshillohet që aparati pedagogjik i çdo mësimi të shoqërohet me rubrikat përkatëse, të cilat pasqyrojnë integrimin e katër aftësive gjuhësore duke shmangur format tradicionale. Ushtrimet për të zhvilluar aftësi të tilla, si: të lexuarit, të folurit, të shkruarit, të degjuarit, të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti të integruara në vetvete dhe në çdo orë mësimi. Puna me shkrimi të jetë pjesë përbërëse e çdo ore mësimore.

Hartuesit të mbështen në parimi didaktik të rimarrjes dhe të riciklimit të njohurive, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e njohurive të dhëna me ato të mëparshme. Këshillohet një mësim përsëritës pas çdo cikli prej 4 mësimesh të reja.

Aparati metodik të mundësojë vendosjen e nxënësit në qendër të procesit mësimor, të sigurojë baraspeshë ndërmjet veprimtarive individuale apo kolektive dhe t’i përshtatet zhvillimit moshor të nxënësve.

Ushtrimet dhe format e punës që lidhen me mësimdhënien ndërvepruese, të jenë të dukshme në strukturën e aparatit pedagogjik të këtij teksti. Ato të jenë veprimtari që t’i përfshijnë nxënësit në forma të gjera zbatuese dhe dalëngadalë edhe krijuese.

Propozohen edhe veprimtari ludike (të lidhura me lojën) që nxënësit të mësohen të bëjnë vetë, të shijojnë dhe të eksperimentojnë veprimtari të larmishme që ngjallin

imagjinatën dhe krijimtarinë e tyre, gjithashtu, të përshtatshme për nivelet e ndryshme të nxënësve në klasë.

Teksti “Gjuha angleze-8” të shoqërohet me udhëzues pedagogjik. Format i metodës të sigurojë pamje të mirë vizive.